**AKTI I THEMELIMIT**

**I**

**SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"IMDIGITAL" sh.p.k**

Sot në datën 05.04.2023 (dymijë e njëzet e tre), unë, **Sindis Kote**, atësia Gjergji, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë, banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Bajram Curri"; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; lindur më 06/03/2001, titullar i Letërnjoftimit ID Nr. 033483413, i regjistuar me Numër Personal **K10306043K**, vendosa të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, **"IMDIGITAL" sh.p.k.**, mbështetur në nenin 2 paragrafi "B" i Ligjit "Për sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit", në ligjin 9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar), në të cilën jam Ortak i Vetëm dhe për këtë qëllim hartoj Aktin e Themelimit, me përmbajtjen si vijon:

**NENI 1**

**EMRI**

**1.1** Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet **"IMDIGITAL" sh.p.k.**, e cila këtu më poshtë do të quhet "Shoqëria".

**NENI 2**

**FORMA**

**2.1** Kjo shoqëri është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

**BAZA JURIDIKE**

**3.1** Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 4**

**SELIA**

**4.1** Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në rrugën "Sadik Petrela", Nd. 1, Nr. Ap. 32.

**4.2** Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.

**NENI 5**

**TERRITORI**

**5.1** Shoqëria e zhvillon aktivitetin si në territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë saj.

**5.2** Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi (zyra përfaqësimi), si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

**NENI 6**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

**6.1** Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Studim dhe analizim i tregut, i konkurrencës dhe targeteve referuese, me objektiv gjetjen e strategjive të komunikimit më efikas;
- Projektimi dhe realizimi i marketingut dhe reklamave në platforma të ndryshme, përfshirë rrjetet sociale;
- Ideimi dhe krijimi i përmbajtjeve publicitare, si video, imazhe dhe tekste, për kanalet e ndryshme të komunikimit;
- Menaxhimi i veprimtarive të 'public relations', aktiviteteve dhe sponsorizimeve;
- Projektimi, zhvillimi dhe administrimi i website, e-commerce dhe platformave dixhitale;
- Krijimi i software-ve të personalizuar për administrimin e proçeseve të biznesit dhe mbledhjes së të dhënave;
- Përdorimi i teknologjive të avancuara për realizimin e zgjidhjeve dixhitale inovative;
- Dixhital marketing, ose aktivitet i promovimit on-line i produkteve dhe shërbimeve nëpërmjet kanaleve dixhitale, si publiciteti on-line, e-mail marketing dhe marketing në social media;
- Planifikimi dhe zhvillimi i strategjive të marketingut për shoqëritë ndërkombëtare, nëpërmjet analizës së tregjeve të huaja dhe përshtatjes së fushatave të reklamave në kontekste të ndryshme kulturore;
- Krijimi i fushatave të marketingut që kanë si objektiv ndërkombëtarizimin e bizneseve, nëpërmjet promovimit të produkteve dhe shërbimeve në tregjet e huaja dhe identifikimit të kanaleve të reja të shpërndarjes.

**NENI 7**

**KOHËZGJATJA**

**7.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim te ortakut te vetëm.

**NENI 8**

**KAPITALI THEMELTAR**

**8.1** Kapitali Themeltar i Shoqërisë është **100 000 leke** (njëqind mijë). Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i Vetëm.

**NENI 9**

**KONTRIBUTET**

**9.1** Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë **Sindis Kote**.

**NENI 10**

**PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR**

**10.1** Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë plotësisht të shlyer.

### NENI 11

**11.1 Administrimi** i shoqërisë do të bëhet nga një administrator. Administrator i shoqërisë është **Sindis Kote**, atësia Gjergji, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Kuçovë, banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Bajram Curri"; Njësia Administrative Nr. 4; Njesia Bashkiake Nr. 4; Tiranë, lindur më 06/03/2001, titullar i Letërnjoftimit ID Nr. 033483413, i regjistuar me Numër Personal **K10306043K**. Ai ushtron këtë detyrë për një periudhë 5(pesë) vjet.

### NENI 12

### DISPOZITA TE FUNDIT

**12.2** Shoqëria do të rregullohet, përveç ketij Akti Themelues edhe me norma te përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm dhe si i tillë do të miratohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

**12.3** Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila fuqi të njëjtë ligjore.

**THEMELUESI**

**Sindis Kote**

Sindis Kote


REPUBLIKA E SHQIPERISE

mbiemri/surname
Kote
emri/given name
Sindis
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Kucove, ALB
datëlindja/date of birth
06-03-2001
data e lëshimit/date of issue
08-09-2017
autoriteti lëshues/authority
MPB

nr. letërnjoftimi/card no.
033483413
gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
07-09-2027
nr. personal/personal no.
K10306043K

ALB
firma/signature